



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Tiranë _____.2023

Shtojca 11

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[27.01.2023]

Drejtuar: [“**LIBRARI DYRRAHU**” shpk *Numri i NIPT-t* L91418502J Adresa: Durrës L.3, Rruga Egnatia/3, Godina 1039, Zona Kadastrale Nr.8514, Volumi 38, Faqe 125, Numri i Pasurisë 4/162-N1.

**Lloji i procedurës së prokurimit: Marrveshje kuadër/me një operator ekonomik /
Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mallra**

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-49604-11-11-2022

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:

“Blerje paisje kancelare për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit per vitin 2022-2023”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 197630-1, 30197643-5, 30192124-6, 30192130-1, 30192160-0, 30192127-7, 22852000-7, 22816100-4, 30197321-2, 30197200-8, 30237132-3, 30192800-9, 30140000-2, 30192110-5, 30192111-2.

Fondi limit: 4,235,578 (katër milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të Vendimit Nr.166, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e Buxhetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për Vitin 2022 dhe vitin 2023.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: deri me date 31.12.2023 sipas nevojave të Autoritetit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 160 datë 21 Nëntor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X
Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**Infosoft OFFICE shpk** *Numri i NIPT-t* **J62426002Q**

Vlera e ofertes ekonomike: **2,615,054** (dy milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e katër) leke pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “**LIBRARI DYRRAHU**” sh.p.k me Nr.NIPTI: **L91418502J**

Vlera e Ofertes ekonomike: **2,770,000** (dy milion e shtateqind e shtatedhjetë mijë) lekë pa TVSH.

3.Operatori ekonomik “**Marketing & Distribution sh.p.k me Nr.NIPTI: J72124001N**

Vlera e Ofertes ekonomike: **2,881,827** (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**Infosoft OFFICE” shpk Numri i NIPT-t J62426002Q**

Vlera E Ofertes: **2,615,054** (dy milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e kater) leke pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të pikës 2, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 3, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi | Përgjigja |
|---|------------------|
| <i>Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE</i> | ----- |
| <i>Numri NIPT/et:</i> | ----- |

| | |
|------------------------------|----------------|
| Adresa postare: | ----- |
| Qyteti / qyteti; Kodi postar | -- |
| Përfaqësuesi (emri): | ----- |
| Telefoni: | ----- - |
| E-mail: | ----- ----- |

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| <i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i> | <i>NIPT –i</i> | <i>Përqindja e nënkontraktimit</i> | <i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i> |
|--|----------------|------------------------------------|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| <i>Emri (at) e subjekteve</i> | <i>NIPT-i</i> | <i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i> | <i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i> |
|-------------------------------|---------------|---|---|
| | | | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | | |
| | | | | |

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**
- Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

• Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

- *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- *çmimet ;*
- *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
- *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

- *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
- *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- *Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, të, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, pri i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Isë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe tit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë atorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; i; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar të çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e ve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore,

ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

| Deklarata | Përgjigje |
|---|------------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar | Po [] Jo [] |

| | |
|----------------------------|--|
| nga Autoriteti kontraktor. | |
| | |

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

| Deklarata | Përgjigje |
|---|--|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | <u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____ | |

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente

duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

KVO konstatoi se dokumenti i vetedeklarimit nuk është paraqitur sipas *shtojcës nr. 8 të dokumentave standarde të tenderit te procedures me objekt “Blerje paisje kancelarie për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit per vitin 2022-2023”*

Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve**”.

Sipas Dokumentave te tenderit ne **Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE.**

| | |
|--|--|
| Dokumentet përbërëse të Ofertës | Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti kontraktor. |
| Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave | Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik <u>paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT.</u> Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim. |

Nga sa me sipër, Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.

SË DYTI: Lista e cmimeve shtojca 2, e paraqitur nga operatori ekonomik Infosoft OFFICE shpk nuk është e sigluar ne cdo flete te saj por vetem ne fund, gje e cila bie ndesh me parashikimin e Dokumentave standarte te tenderit ku percaktohet qarte:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE.

Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve:Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Cdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

- **SË TRETI:** Autoriteti kontraktor ka kerkuar në dokumentate Tenderit: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë nga një mostër, për listen e artikujve objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Për mallrat që kërkohet të jenë të loguara sipas shtojcës 5, duhet të paraqiten mostra të loguara, sipas listes .Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.*

| NR | PËRSHKRIMI |
|----|--|
| 1 | Dosje me mekanizëm me kuti me permasa 28cm x 34cm x 6 cm |
| 2 | Dosje me mekanizëm me kuti me permasa 28cm x 34cm x 8 cm |
| 3 | Dosje kuti Arkivi me permasa 40cmx27cmx18cm standart shteteror me veshje te perforcuar me kapak |
| 4 | Makinë kapëse 24/6 |
| 5 | Makinë kapëse 23/10 |
| 6 | Makine grirese letre Cross Cut deri ne 100flet/10fleta njeheresh,per kapse aktesh,cd,dvd,karta,etj |
| 7 | Letër A4, 80 g/m2 |

Ne permbushje te kriterit, OE “Infosoft OFFICE” shpk Numri i NIPT-t J62426002Q ka paraqitur mostrat pranë Autoritetit Kontraktor: **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, në datën dhe orën e hapjes së ofertave.**

Ajo qe u konstatua nga KVO gjate shqyrtimit te mostrave ishte se:

Se pari: Operatori ekonomik nuk i ka paraqitur mostrat sipas kriterit ku nder te tjera percaktohet se”**duhet të paraqiten mostra të loguara, sipas listes**”, mostrat nuk jane as te loguara me Nr. Artikulli as te vulosura nga operatori ekonomik.

Se dyti: Persa i perket mostrave te paraqitura, Gjatë procesit të shqyrtimit te mostrave te paraqitura nga operatorët ekonomik te interesuar, u konstatua se ne mostrat e paraqitura nga të tre operatorët ekonomik per artikullin “Letër A4, 80 g/m2” nuk ka te dhena teknike, apo specifikime teknike te letres ne amballazh.

Me anë të shkresës me Nr. 10065/10 datë 19.12.2022 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82, pika 2 ku percaktohet se: “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

Kërkoj nga operatorët ekonomik, Skedën teknike për letrën A4, me qëllim, shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të mostrave, mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Operatori ekonomik “Infosoft OFFICE shpk ne përgjigje te shkresës me Nr. 10065/10 datë 19.12.2022 “Kerkese per sqarim” me ane te se ciles eshte kerkuar **Skeda teknike për letrën A4, me qëllim, shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të mostrave, mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit.**

Infosoft OFFICE shpk ka paraqitur pranë Autoritetit kontraktor “kthim pergjigje kerkeses per sqarim” ne formen e deklarates se permbushjes se specifikimeve teknike, dhe nuk ka paraqitur skeden teknike per artikullin sipas kerkeses se

Autoritetit, nderkohe Autoriteti Kontraktor ka kërkuar shprehimisht: Kërkoj nga operatorët ekonomik, Skedën teknike për letrën A4.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Nga sa më sipër autoriteti kontraktor vendos të mos marrë në konsideratë sqarimet e paraqitura **Infosoft OFFICE shpk**, pasi nuk janë sipas kërkeses se autoritetit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**LIBRARI DYRRAHU shpk** Numri i **NIPT-t** L91418502J Adresa Durres L.3, Rruga Egnatia/3, Godina 1039, Zona Kadastrale Nr.8514, Volumi 38, Faqe 125, Numri i Pasurisë 4/162-N1, se oferta e paraqitur me Vlerën: 2,770,000 (dy milion e shtateqinde shtatedhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar është identifikuar si oferta e suksesshme.

* * *

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej : **2,881,827** (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzetë e shtatë) lekë pa TVSH., siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO X JO

Nëse Po (Vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës Nr. 2900/ 6 prot. Datë 24.01.2023
V E N D I M Nr. 50/2023)

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYEINSPEKTOR

Mariglen QATO